



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **07.05.2024** me fillim në ora **10:05**. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**.
Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për praninë tuaj. Përshëndetje për përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, shefin e ZKK-së Lendrit Qelin, drejtorin e Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi, anëtarët e komitetit dhe gjithë të pranishmit. Ky është takimi i dytë për vitin 2024, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Gjendja e infrastrukturës në vendbanimet e komunitetit joshumicë;
3. Vizitë në Sh.F.M.U “Gëzim Hamza-Piktori” - Rahovec, në Sh.M.L “12 Maji” dhe Sh.F.M.U “Katër Dëshmorët” - Ratkoc;
4. Të ndryshme.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: Pas miratimit të rendi të ditës, a ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë unanime procesverballi kalon.

2. Gjendja e infrastrukturës në vendbanimet e komunitetit joshumicë;

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket infrastrukturës publike në zonat me banim të komunitete, në komunën tonë nuk ka dallime në investime dhe një projekt voluminoz që do të ndodh shumë shpejt dhe kryesisht do të përfshihet zona ku janë komunitetet është projekti i ujit të pijshëm, duke përfshirë komunitetin në fshatin Hoçë e Madhe dhe vendbanimet tjera në Optrushë dhe Zoqisht. Jemi në fazën fillestare të projektit dhe shumë shpejt do të realizohen procedurat e tenderimit. Është një investim i madh prej 1.2 milion, me bashkëfinancim nga Ministria e Ekonomisë, K.R.U Gjakova dhe Komuna e Rahovecit. Përveç kësaj, në Ratkoc jemi duke i trajtuar disa rrjete të kanalizimit të ujërave të zeza dhe në lagjen e epërme së fundi janë bërë disa përmirësime në infrastrukturë, duke përfshirë ndriçimin publik. Kemi filluar me mirëmbajtje të hapësirave publike duke përfshirë pastrimin e deponive ilegale në zonat ku janë komunitetet. Kemi ndërtim të rrugëve lokale në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm. Kërkesat e adresuara nga komunitetet, besoj se të gjitha janë realizuar, ose janë në implementim.

Lendrit Qeli: Dëshiroj t’i shtoj edhe disa projekte të tjera që kanë ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës në vendbanimet e komuniteteve, ose që ndërlidhen me komunitetet. Renovimi i terrenit sportive në lagjen e epërm, në shkollën “Gëzim Hamza” – Piktori. Sot pritet të hapen ofertat për terrenin e ri sportive në fshatin Dobidol. Janë dy projekte kapitale dhe presim projekte tjera të radhës. Kemi aplikuar në njërin prej organizatave ndërkombëtare “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians” diçka në lidhje me infrastrukturë, por nuk guxojmë ta bëjmë publike, derisa ta marrim aprovimin prej organizatës. Si kërkesë e vazhdueshme e anëtarëve të Komitetit për Komunitete dhe anëtarëve të KKS-së, janë vendosur edhe disa pengesa në disa rrugë lokale.

3. Vizitë në Sh.F.M.U “Gëzim Hamza-Piktori” - Rahovec, në Sh.M.L “12 Maji” dhe Sh.F.M.U “Katër Dëshmorët” - Ratkoc;

Kryesuesi: Sapo morëm informatë nga drejtori i DKA-së që për shkak të angazhimeve, kjo vizitë e sotme nuk mund të realizohet. Besoj që në takimin e radhës do të dalim në vizitë në shkollat e lartcekura.

Skender Hamza: Përshëndetje kryesues, zëvendëskryesues, anëtarë, koleget nga zyra e informimit, kolegun Albion! Sa i përket pikës së tretë, ju si komitet i njoftoni drejtorët e shkollave që do t’i vizitoni. Si komitet, keni të drejtë të vazhdoni në terren edhe pa drejtorin e DKA-së. Në fund, ju i bëni rekomandimet dhe informatat që i merrni prej shkollave ia drejtoni DKA-së, apo kuvendit për shqyrtim.

Edonita Berisha: Përshëndetje për të gjithë! Më pëlqen shumë kjo pikë e rendit të ditës që ka të bëjë me vizita nëpër shkolla. Unë personalisht kam shkuar tre vite në shkollë të mesme dhe e kam parë se sa pak fëmijë kemi në shkolla të mesme. Më duken të rëndësishme vizitat e tilla, t’i motivojmë nxënësit dhe t’i japim informacione të ndryshme lidhur me shkollë, pasi që është edhe fundi i vitit të klasave të nënta.

Lendrit Qeli: Në takimet që i kemi pasur bashkë, ju kam sugjeruar që të vizitohet fillimi i punës së qendrës së komunitetit, që gjendet në shkollën “Gëzim Hamza – Piktori”. Është një projekt shumë i madh dhe shpresoj që frytet e atij projekti do t’i shohim në të ardhme. Sidomos angazhimin e të rinjve në shkolla të mesme, sepse këtu çalojmë.

Kryesuesi: Faleminderit z. Lendrit! Besoj që jemi dakord të dalim në vizita të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete.


4. Të ndryshme;

Lendrit Qeli: Kam dëshirë që secili prej nesh ta përcjell mesazhin e regjistrimit të popullatës, posaçërisht te pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në vendin tonë. Kam arritur t’i shoh pak rezultatet dhe nuk kam parë asnjë pengesë apo hezitim për regjistrim. Kam vërejtur hezitim në deklaram të përkatësisë. Në domenin tonë na takon që secili prej anëtarëve ta ngris vetëdijen nëpër vendbanimet ku ata jetojnë, që lirshëm ta shprehin përkatësinë e tyre etnike, duke na ndihmuar shumë që t’i krijojmë strategjitë dhe planifikimet tona buxhetore në të ardhmen.

Kryesuesi: Faleminderit z. Lendrit! Nëse nuk ka dikush ndonjë gjë tjetër, ju falënderoj për vëmendjen! Shihemi në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi: 10:25

Procesmbajtësi;


Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes;


Bajram Morina

